



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	20/05/2026		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/03	18092	



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit  
Drenas, më 20.05.2026

## F t e s ë

### Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën **29.05.2026**, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të pranuar komentet, sugjerimet, propozimet dhe kërkesat hartimin e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029**.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2027-2029 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Komentet, kërkesat, propozimet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 30.05.2026 në orën 16:00, në e-mail-at e zyrtarëve: [enver.m.hoxha@rks-gov.net](mailto:enver.m.hoxha@rks-gov.net) ; [bekim.dobra@rks-gov.net](mailto:bekim.dobra@rks-gov.net) [avdyl.mziu@rks-gov.net](mailto:avdyl.mziu@rks-gov.net) dhe [komuna.drenas@rks-gov.net](mailto:komuna.drenas@rks-gov.net)

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:  
<https://glogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Platformën për Konsultime Publike:  
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:

Dëgjimet publike për KAB	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, Drejtor të shkollave, mësime dhënë, biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	29.05.2026	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!



**Behim Dobra**

**Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun**